

VENDIM
Nr. 78, datë 8.6.2015

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA SHOQËRIA “UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË” SHA TE SHOQËRIA “HEC
LANABREGAS” SHA

Në mbështetje të neneve 9; 19 dhe 20, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 17, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e datës 8.6.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 99, datë 13.9.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. Aplikimi i shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1 (neni 17, pika 4, germa “a”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Informacionin me shkrim, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës (neni 17, pika 4, germa “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës (neni 17, pika 4, germa “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

2. Aplikimi i shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a., për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatin e aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të transferojë licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 145, seria PV11SH miratuar me vendimin nr. 99, datë 13.9.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nga shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., te shoqëria “HEC Lanabregas” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a. dhe “HEC Lanabregas” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti